

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

3963
Nr. _____ Prot

Peshkopi, më **06/10**.2025

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr. 52

Datë: 01.10.2025 si dhe projekt-vendimin **nr.02 Datë 22.09.2025.**

**“PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT PËR “KRYERJEN E
PUNIMEVE PËR KOMPLETIMIN E URËS METALIKE TIP BAILEY”, MBI LUMIN
DRIN,NJËSIA ADMINISTRATIVE MUHURR,BASHKIA DIBËR”.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak





3963/
11/3/10/25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.904/1 prot.

Peshkopi, më 10.10.2025

Lënda: Për vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër..

BASHKISË


DIBËR

Në mbështetje të nenit 16-të të ligjit nr.107 datë 27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin nr.52 (pesëdhjetë e dy) datë 01.10.2025, të Këshillit të Bashkisë Dibër, "Për ndërhyrje në infrastrukturë kritike për emergjencat civile ", **vendosa:**

Miratimin në parim të kësaj vendimmarrje në kushtet e respektimit të legjislacionit aktual në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e së drejtës përkatëse.

Duke ju falenderuar për mirkuptimin.

PREFEKTI
Nexhbedin SHEHU





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

VENDIM

Nr. 52 Datë 01/10/2025


“PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT PËR “KRYERJEN E PUNIMEVE PËR KOMPLETIMIN E URËS METALIKE TIP BAILEY”, MBI LUMIN DRIN,NJËSIA ADMINISTRATIVE MUHURR,BASHKIA DIBËR”.

Bazuar në ligjin nr.139/2015 për vetëqeverisjen vendore,i ndryshuar,Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Ligji nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit,Ligji nr.64/2014 “Për pushtetin dhe autoritetet e drejtimit të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, VKM nr. 965 datë 02.12.2015 “Për bashkëpunim ndërinstitucional të strukturave të drejtimit,në rastet e emergjencave civile dhe krizave, Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes nr.1645, datë 27.08.2025 “Për kryerjen e punimeve për kompletimin e urës metalike tip “bailey” mbi lumin Drin,Njësia Administrative Muhur, Bashkia Dibër,Marrëveshjes së bashkëpunimit datë 12.09.2025 mes Ministrisë së Mbrojtjes dhe Bashkisë Dibër, Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës **01.10.2025** me 18 vota pro 1 kundër 2 apstenim :

VENDOSI:

1. Të miratoj marrëveshjen e bashkëpunimit për kryerjen e punimeve për kompletimin e urës metalike tip “Bailey” mbi lumin Drin,Njësia Administrative Muhur, Bashkia Dibër .
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe zhvillimit të territorit,Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria Ekonomike,Drejtoria Juridike,Bashkia Dibër.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
4. Vendimi u shpall më datë **01.10.2025**.

Zv/Kryetar i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA JURIDIKE, E PROKURIMEVE DHE PRONAVE
P/ VENDIM

Nr. 02 date 22/09 / 2025

“Për miratimin e marrëveshjes së bashkpunimit për “Kryerjen e punimeve për kompletimin e urës metalike tip “Bailey”, mbi lumin Drin, Njësia Administrative Muhurr, Bashkia Dibër”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, Ligji nr.44/2015 Kodi I Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Ligji nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, Ligji nr.64/2014 “Për pushtetet dhe Autoritet e drejtimit të Komandimit të Forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë”, VKM nr.965, datë 02.12.2015 “Për bashkpunimin ndërinstitutional të strukturave të drejtimit, në rastet e emergjencave civile dhe krizave”, Urdhëri I Ministrit të Mbrojtjes nr.1645, date 27.08.2025 “Për kryerjen e punimeve për kompletimin e urës metalike tip “bailey” mbi lumin Drin, Njësia Administrative Muhurr, Bashkia Dibër, Marrveshjes së Bashkpunimit datë 12.09.2025 mcs Ministrisë së Mbrojtjes dhe Bashkisë Dibër.

KËRKOJMË:

1. Te miratojë marrëveshjen e bashkpunimit për kryerjen e punimeve për kompletimin e urës metalike tip “Bailey”, mbi lumin Drin, Njësia Administrative Muhurr, Bashkia Dibër.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Drejtoria e Shërbimeve dhe Drejtoria Ekonomike.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Keshillit Bashkiak Diber dhe shprehjes për bazueshmeri ligjore nga institucionit të Prefektit të Qarkut Diber.

Drejtori Dpzh

Drejtori Juridik

Drejtori Ekonomik

Drejtorii i Mbrojtjes Civile

Blerina Mazari




Ismet SARACI



Çeljeta ZUNA



Sajmir SHEHUI




KRYETARI I BASHKISE
Rahim SPAHIU

ME URDHER DHE ME POROSI

ZV/KRYETARI

Lorenc CIBAKU





REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E MBROJTJES
KOMANDA MBESHTETËSE

BASHKIA DIBËR

Batalioni i Xhenios

Nr. 1430/Regj. Tiranë, më 09/09/2025
2

Nr. 3528/Regj. Peshkopi, më 12/09/2025
1

AKT-MARRËVESHJE

**PËR KRYERJEN E PUNIMEVE PËR KOMPLETIMIN E URËS METALIKE
TIP "BAILEY", MBI LUMIN DRIN, NJËSIA ADMINISTRATIVE MUHURR,
BASHKIA DIBËR**

E lidhur sot më datën.../09/2025 ndërmjet Repartit Ushtarak Nr. 4040 Tiranë përfaqësuar nga komandanti i këtij reparti, Kolonel Shkëlzen **Mhillaj** dhe Bashkisë Dibër, të përfaqësuar nga kryetari Z. Rahim **Spahiu**, për kompletimin e urës metalike tip "bailey", mbi lumin Drin, njësia administrative Muhurr, bashkia Dibër.

1.BAZA LIGJORE

- Lgji nr.64/2014 "Për pushtetet dhe Autoritetet e drejtimit të Komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.965, datë 02.12.2015 "Për bashkëpunim ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e emergjencave civile dhe krizave";
- Ligji Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore";
- Udhëzimi i MF nr. 30 datë 27.12.2011 "Per menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" me ndryshimet përkatëse;
- VKM nr.329 datë 20.04.2016 "Për disa ndryshime në VKM nr.997 datë 10.12.2010 për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brënda vendit";
- Urdhëri i Ministrit të Mbrojtjes nr.1645, datë 27.08.2025 "Për kryerjen e punimeve për kompletimin e urës metalike tip "bailey", mbi lumin Drin, njësia administrative Muhurr, bashkia Dibër";
- Urdhëri i komandantit të KM nr.629 datë 01.09.2025 "Për kryerjen e punimeve për kompletimin e urës metalike tip "bailey", mbi lumin Drin, njësia administrative Muhurr, bashkia Dibër.

2.OBJEKTU AKT-MARRËVESHJES

- Kryerje punimesh për kompletimin e urës metalike tip "bailey", mbi lumin Drin, njësia administrative Muhurr, bashkia Dibër.

3.VENDI I PUNIMEVE

- Mbi lumin Drin, njësia administrative Muhurr, bashkia Dibër.

4.PËRGJEGJËSITË DHE DETYRIMET MIDIS PALËVE

REPARTI USHTARAK NR. 4040

1.Të kryejë punimet për kompletimin e urës metalike tip "Bailey", me gjatësi 135m me seksion 2/1, me pesë hapësira drite me gjatësi ure për kampatë 27m, mbi lumin Drin, njësia administrative Muhurr, bashkia Dibër.

2.Të angazhojë mjetet dhe 12 specialiste për një periudhë 15 ditore për kryerjen e operacionit për ndërtimin e urës sipas listës së miratuar.

3. Të marrë në dorëzim me dokumentacion sipas akteve ligjore sasinë e karburantit të parashikuar për furnizimin e mjeteve të angazhuara në këtë operacion.

4. Të kryejë pandërprerje punimet për montimin e urës Bejli, edhe ditët e pushimit, pasi detyra është vlerësuar operacion special.

5. Në bashkëpunim me Bashkinë Dibër, të bëjë dorëzimin e urës Bejli, me akt-dorëzimi të nënshkruar nga të dy palët dhe të mbyllë dokumentacionin përkatës.

6. Të dërgojë në bashkinë Dibër konformartjet e karburantit me gjithë dokumentacionin shoqërues të harxhimit.

BASHKIA DIBËR

1. Të sigurojë kushte të përshtatshme në objekt për kryerjen e operacionit, ruajtjen e mjeteve në vendin e punës dhe në parkim, deri në përfundim të detyrës.

2. Të caktojë person përgjegjës për mbikqyrjen dhe kordinimin e punës me efektivat e batalionit të xhenios në zonën e operacionit.

3. Të kryejë furnizimin e mjeteve të Batalionit të Xhenios me karburant-lubrifikant në sasinë 1300 litra naftë dhe 28 litra lubrifikant.

4. Të bëjë trajtimin financiar me dietë të plotë personelin e angazhuar për ndërtimin e urës për 15 ditë në vlerën; 12 specialistë x 15 ditë x 5500 lekë = 990000 lekë, sipas listës së miratuar.

5. Të sigurojë lëndë drusore me gjatësi 4m dhe trashësi t=6cm, në sasinë 30 m³, vidat për montimin e saj dhe të realizojë mbështetjen e operacionit për shpenzime të tjera plotesuese në masën deri 2% të kostos së operacionit.

6. Me përfundimin e punimeve, në bashkëpunim me përfaqësuesit e Batalionit të Xhenios, të marrë në dorëzim urën me dokumentacionin përkatës dhe të zbatojë të gjitha kushtet e shfrytëzimit të urës të përcaktuara në aktin e dorëzimit të urës.

TË PËRBASHKËTA PËR TË DY PALËT

1. Ura e riparuar i dorëzohet Bashkisë Dibër për administrim, përdorim, ruajtje e mirmbajtje të mëtejshme dhe ku përcaktohet peshëmbajtja, kërkesat teknike të shfrytëzimit të saj, dhe që kjo urë mbetet pronë e Ministrisë së Mbrojtjes.

2. Në rast emergjence, apo të ndonjë detyre nga komanda eprore, mjetet dhe forcat mund të kthehen në repart, pa e përfunduar detyrën.

3. Për mosmarrëveshje, palët të drejtohen në komandën eprore që ka dhënë urdhërin.

5. DATA E FILLIMIT TË PUNIMEVE

Punimet të fillojnë më datën2025, deri në përfundim të detyrës.

Kjo aktmarrëveshje firmoset para fillimit të punimeve, mbahet në dy kopje dhe firmoset nga secila palë.

PËR REPUSHT. NR. 4040

KOMANDANT SHKËLZEN MHILLAJ

KOMANDANTI



PËR BASHKINË DIBËR

Z. RAHIM SPAHIU

